

Thirrja është e hapur nga data 06.05.2024 deri më 13.05.2024

TERMAT E REFERENCËS

Kontraktimi i një kompanie e cila punon video animacione.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI” NRF: 601188700 Rr.Adnan Krasniqi nr.149 Hyrja II nr.8 Prizren.
Objektivi i thirjes	Krijimi i Video Animacion për kampanjën e regjistrimit dhe rëndësin e shkollimit të shkollave profesionale.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizim dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumtave dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji tetor të viti 2023 ka filluar të zbatojë projektin “Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Projekti po zbatohet në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ “Nevo Koncepti” në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

3. OBJEKTIVA

OJQ “Nevo Koncepti” synon të angazhojë një kompani e cila krijon video animacione në bazë të kërkesës nga ana e OJQ”Nevo Konceptit”, qëllimi video animacionit është reflektim dhe vetëdijësimi tek komunitetet rom,ashkali, egjiptian dhe jo vetem, për rëndësin e regjistrimit të fëmijëve në shkollat e mesme profesionale.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Bashkëpunon ngusht me menaxherin e projektit për realizimin e idesë për krijimin e video animacionit.
- Realizon krijimin e animacionit në bazë të kërkesës së organizatës kontraktuese.
- Punon në favor të kontratës së nënshkruar.
- Gjiron zërin e personazheve në video animacion.
- Krijon dhe përshtatë skenarin e videos në përputhje me idenë e dhënë nga ana e menaxherit të projektit.
- Të jetë i përpikët në afatin kohor të caktuar për përfundimin e videos animacionit.
- Të siguroj faturën e rregullt me të gjitha informacionet përcjellëse të cilat duhet të posedoj një faturë pas finalizimit dhe dorëzimit të videos.

5. POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

Si kusht për lidhjen e një marrëveshjeje, kompania kontraktuese duhet të nënshkru dokumentin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si politikë e organizatës kontraktuese.

6. AFATI KOHOR

Afati kohorë për përfundimin e video animacionit duhet të jetë jo më largë se 19.05.2024.

7.PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë kompanitë e interesuara për aplikim duhet të ofrojnë këto dokumente:

1. Oferta në emër të OJQ”Nevo Konceptit”
2. Dokumentin e ARBK-s
3. Kopja e ID-s së përfaqësuesit të kompanis.

Ofertat duhet të dërgohet jo më largë se data 13.05.2024 në formë fizike ose përmes email m.elshani@nevokoncepti.org duke kopjuar në (cc) o.osmani@nevokoncepti.org